




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN



VENDIM

Nr.4, datë 24.03.2022

PËR

**KORRIGJIMIN EKOORDINATAVE DHE MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES “PËR PËRDORIM TËBURMIT UJOR NËNTOKËSOR ME NR. 658/1 PORT., DATË 14.07.2017 MIRATUAR ME VENDIM NR.6 DATË 29.06.2017 NGA KBU SEMAN”, DHËNË NË FAVOR TË SHOQËRISË “BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD”**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

**V E N D O S I:**

1. Korrigjimin e koordinatave të lejes nr.prot.658/1, datë 14.07.2017 miratuar me vendimin nr.6, datë 29.06.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Seman si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit (KRGJSH)

Nga: X=471303; Y= 4509572.3; Z= 12.2 m.m.n.d.

Në : X=471366.6; Y= 4511514; Z= 8 m.m.n.d.

Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=9.25l/s

2. Miratimin e rinovimit të lejes nr.658/1,prot., datë 14.07.2017 miratuar me vendimin nr.6, datë 29.06.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Seman për “Përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime teknologjike” sipas këtyre të dhënave:

Vendndodhja e pus shpimit (KRGJSH)

Në : X=471366.6; Y= 4511514; Z= 8 m.m.n.d.

Sasia e ujqit që jepet në përdorim: Q=0.00925 m<sup>3</sup>/s

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU SEMAN**

**LEFTER SHEHAJ**

